



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZLAnr.338/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krsniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Driton Sylja anëtarë për kuvendin komunal të Komunës së Skenderaj nga radhët subjektivit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë dega në Skenderaj për shkak të listës së kandidatëve për anëtarë të kuvendit të Komunës së Skenderaj, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt ankesa e Driton Sylja anëtarë për kuvendin komunal të Komunës së Skenderaj nga radhët subjektivit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me ZL.Anr.338/2017 e datës 22.10.2017, për shkak të listës së kandidatëve për anëtarë të kuvendit të Komunës së Skenderaj, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Driton Sylja anëtarë për kuvendin komunal të Komunës së Skenderaj, me të cilën ka pretenduar se nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është certifikuar me numër 19 në listë, ndërsa me datë 22.10.2017 ka vërejtur se i njëjti ka numër 18 në listën për anëtarë të kuvendit komunal në Skenderaj dhe kjo si rezultat se KQZ ka tërëqur nga lista një kandidat dhe nuk e ka njoftuar të njëjtin e as subjekti politik AAK.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një listë në lidhje me rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e subjektivit politik AAK është e parregullt, sepse nuk është e precizuar shkelësi i supozuar dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.7 ku përcaktohet që ankesa duhet të përmbajë: emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të shkelësit të pretenduar.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZLAnr.338/2017 më datën 22.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevc



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*